STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 28 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) SHTYN DATEN E KRYERJES SE PAGESAVE PER MBAJTESIT E POLICAVE TE SIGURIMIT TE FONDIT TE SIGURIMEVE SHTETERORE TE NJU JORKUT (NEW YORK STATE INSURANCE FUND) TE PREKUR NGA URAGANI SENDI (SANDY)

Mbajtësit e policave nuk do të paguajnë premiumet deri vitin e ardhshëm

Fondi i Sigurimeve Shtetërore të Nju Jorkut (New York State Insurance Fund) ofron gjithashtu kushte fleksibël të pagesave për të gjithë mbajtësit e policave

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Fondi i Sigurimeve Shtetërore të Nju Jorkut (New York State Insurance Fund) është duke shtyrë afatet kohore të pagesave për të gjithë mbajtësit e policave të prekur drejtpërdrejt nga Uragani Sendi (Sandy). Për mbajtësit e prekur të policave të kompensimit të punëtorëve dhe përfitimet e pa-aftësisë në 10 qarqet e Nju Jorkut (New York) - Bronks (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Oranxh (Orange), Riçmond (Richmond), Roklënd (Rockland), Safolk (Suffolk), Kuins (Queens) dhe Uestçestër (Westchester) - me një datë të kryerjes së pagesës së premiumit ndërmjet 26 tetor - 26 dhjetor 2012, afati kohor i pagesës shtyhet deri më 26 janar 2013. Në të vërtetë, të gjithë mbajtësit e policave do të marrin një periudhë falje prej minimumi 30 ditë dhe disa mbajtës të policave mund të marrin një periudhë falje prej deri në 90 ditë. Përveç kësaj, nuk do të ketë asnjë pagesë ndëshkuese ose anullime gjatë kësaj kohe për mbajtësit e prekur të policave.

“Bizneset vendore janë ende duke u përpjekur që të ndërtohen pas Uraganit Sendi (Sandy) dhe jemi të përkushtuar që të vazhdojmë t’i ndihmojmë ata që të rimëkëmben në javët dhe muajt e ardhshëm,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Komunitetet e prekura nga stuhia varen mjaft nga aftësia e bizneseve tona vendore që të kenë fleksibilitetin dhe burimet që u nevojiten për t’u kthyer në biznes. Përveç burimeve financiare dhe ndihmës që Shteti është duke u ofruar tashmë bizneseve, jemi duke siguruar shtyrje deri në 90 ditë për pagesat e premiumeve për të ndihmuar që bizneset të rimëkëmben.”

Fondi i Sigurimeve Shtetërore (State Insurance Fund) u bën thirrje mbajtësve të policave të tij që të kontaktojnë me agjentin e tyre me informacionin e rishikuar të pagave, në mënyrë që Fondi të mund të rregullojë premiumet e tyre dhe të vendosë plane pagesash që do t’i lejojnë të rimëkëmben më shpejt. Fondi i Sigurimeve Shtetërore (State Insurance Fund) ka vendosur gjithashtu procedura më fleksibël për

vlerësimin e mbulimit dhe vendosjen e tarifave të premiumeve, duke e kuptuar se punonjësit e prekur mund të mos kenë mundësinë e përdorimit të menjëhershëm të raporteve të pagave dhe rregjistrave të tjera financiare. Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi kontaktoni zyrën tuaj vendore të biznesit ose NYSIF në 1-877-898-8308.

Përveç këtyre përpjekjeve, Fondi i Sigurimeve Shtetërore (State Insurance Fund) gjithashtu pezulloi menjëherë anullimet e policave per mospagesë për 30 ditë pas stuhisë. Deri më 23 nëntor, NYSIF rivendosi 8,903 polica për 7,834 mbajtës të policave të kompensimit të punëtorëve dhe 1,069 mbajtës të policave të përfitimeve të pa-aftësisë.

“Fondi i Sigurimeve Shtetërorë (State Insurance Fund) është i gëzuar që ofron ndihmë për ata që janë prekur nga stuhia,” tha Zëvendës/Drejtori Krye Ekzekutiv Denis J. Heis (Dennis J. Hayes). “Do të vazhdojmë të vlerësojmë se ç’farë hapash duhen të merren për të siguruar se ofrojmë shërbime për konsumatorët tanë pa burokraci dhe vonesa të gjata.”

Ju lutemi shihni faqen e Uraganit Sendi (Sandy) të Fondit të Sigurimeve Shtetërore të Nju Jorkut (New York State Insurance Fund) për më shumë informacion në http://ww3.nysif.com/AboutNYSIF/NYSIFNews/HurricaneSandy.aspx, si dhe faqet në Facebook (www.facebook.com/newyorkstateinsurancefund) dhe Twitter (www.twitter.com/NYSIF_1914) për informacion të azhornuar.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418